

# STATUTI

## I SHOQERISE ONE PRO Sh.P.K

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar ONE PRO Sh.p.k themelohet ne perputhje me ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" nga ortaket Ramazan Allushi dhe Adriatik Molla.

### Kreu I

#### Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

#### Neni 1:

#### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 30 Mars 2022, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin ONE PRO SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë :

1. Ramazan Allushi, i biri i Dervishit, lindur me 26.02.1984 ne Kruje, banues ne Kruje, Lagjja nr. 1, Rruga Perlate, ndertese private 1 kateshe, zona kadastrale 8621, me nr. pasurie 6/233, me karte identiteti ID nr. **029836778** dhe nr. personal **I40226007U**.
2. Adriatik Molla, i biri i Hekuran, lindur me 08.06.1983 ne Tirane, banues ne Tirane, Rruga Dritan Hoxha Nd.147; Njesia Administrative Nr.7;1023; Tirane, me karte identiteti ID nr. **034976056** dhe nr. personal **I30608044O**.

#### Neni 2:

#### Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Call Center, Import, Eksport, Tregtim me shumice dhe pakice i mallrave, sherbime etj.. Prodhim e Tregtim me shumice dhe pakice , i produkteve dhe nenprodukteve bujqesore dhe blegtorale, eksport-import dhe perpunimi e ambalazhim i tyre, ushqimeve per blegtorine, farerave, fidaneve etj. Hoteleri, bar-kafe dhe restaurant kamping. Prodhim, tregtim e ambalazhim i mishit dhe formave te perpunimit te tij. Ngritja e fidanishteve dhe serave per prodhimet bujqesore etj. Tregtim dhe prodhim i materialeve te ndertimit, etj. Transport i udhetareve dhe i mallrave brenda dhe jashte vendit etj.

E gjithë veprimtaria e shoqërisë , pamvaresisht nga objekti i saj, do te mbeshetet ne licensat e leshuara per kete qellim nga organi shteteror perkates kur nje e tille kerkohet nga legjislacioni.

#### Neni 3:

#### Kohëzgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga dita e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Bisnesit.

#### **Neni 4:**

##### **Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën Tirane,Rruga “Dritan Hoxha” Zona Kadestrale 8210 nr. Pasurie 1/537-N4 Tirane.

#### **Kreu II**

##### **Kapitali**

#### **Neni 5**

##### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është me dy kuota me vlere te pergjitheshme 100000 Lekë . Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Ramazan Allushi: Ka nje kute me vlere te pergjitheshme 50000 leke qe perben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

2.Ortaku themelues Adriatik Molla: Ka nje kuote me vlere te pergjitheshme 50000 leke qe perben 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100000 leke

Vlera e paguar: 0

Kontributet në para do të paguhen, menjëherë pas regjistrimit në QKR,ne llogarine bankare qe do hapet ne emer te shoqerise.

#### **Neni 6:**

##### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga asambleja e pergjitheshme, e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

Pjeset e kapitalit aksionar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri,vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te kapitalit aksionar.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, pas miratimit ne asamblene e pergjitheshme te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**

##### **Neni 8**

###### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve merr vendime per cheshtjet e meposhtme:

- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- përcaktimin e shpërblimeve për administratorët;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e pergjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e pergjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

##### **Neni 9**

###### **Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e pergjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 15 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

##### **Neni 10**

###### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e pergjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e pergjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e pergjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 11

### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## Neni 12

### Përfshirja nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13

### Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë per nje periudhe 5-vjecare nga momenti i rregjistrimit ne QKB.

1.Ramazan Allushi,i biri i Dervishit,lindur me 26.02.1984 ne Kruje,banues ne Kruje,Lagjja nr. 1,Rruga Perlate,ndertese private 1 kateshe,zona kadastrale 8621,me nr.pasurie 6/233, me karte identiteti ID nr. **029836778 dhe nr.personal I40226007U**.

2.Adriatik Molla ,i biri i Hekuran,lindur me 08.06.1983 ne Tirane,banues ne Tirane,Rruga Dritan Hoxha Nd.147;Njesia Administrative Nr.7;1023;Tirane, me karte identiteti ID nr.034976056 **dhe nr.personal I30608044O**.

## Neni 14

### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## **Neni 15**

### **Përgjegjësia e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV**

##### **Viti financiar-ekspertet**

#### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### **Neni 17**

##### **Ekspertet**

Eksperti emerohet nga asambleja e ortakeve per auditimin e pasqyrave financiare kur kerkohet nga ligji apo detyra te tjera qe caktohen nga aksioneret..

Ne perfundim te auditimit apo kryerjes se detyrave te caktuara nga ortaket, eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim dhe eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe kane.

#### **Kreu V**

##### **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

#### **Neni 18**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

#### **Neni 19**

##### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

#### **Neni 20**

##### **Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 21**

##### **Mosmarrëveshjet**


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### ***ORTAKET***

#### ***E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR***

##### **ONE PRO**

Ramazan Dervish Allushi



Adriatik Hekuran Molla

